

Ekspozitë



Dhuna nuk
fshehet
mrena mureve

Mrena Mureve

Te na, viktimat e dhunës në familje hala fshehen mrena mureve t'shpisë. E kur njerëzit e ndëgjojnë dhunën tek kojshitë, hala thojnë “Çka bojnë ata mrena shpisë tyne, osht' punë për ta”.

Kjo ekspozitë shpalosë veç disa prej tregimeve të vërteta të grave dhe burrave që kanë përjetu dhunë në familje, të mledhuna nga Rrjeti i Grave të Kosovës.

Hajde, merr guximin parakalo mrena ktyne mureve, mrena ktij labirinti. Veç kujdes, kujdes se munesh me u hutu, me u çorientu, e besa edhe me u dëshpëru... Kujdes, se munesh me u ni qashtu qysh nihen 68% e grave që kanë përjetu dhunë në Kosovë.

Hajde, e meno edhe ti: Qysh mujm me i rrëzu këto mure bashkë?
Qysh mujm me ju dhon' fund ktyne vujtjeve t'heshtuna?

21% e Kosovarëve hala thojnë se:

**"Najherë osht' në
rregull që një burrë me
goditë grun e tij"**

**Fëmija nuk disiplinohet
me shuplaka.**

Çdo i 3-ti Kosovar hala mendon se po.

**Nuk osht' arsyetim
me rreh grun veç pse
je i papunë.**

Çdo i 4-ti Kosovar se din.

**S'ka gajle a jeni
t'martun. Marrdhanja
seksuale me zor osht'
dhunë.**

Çdo i 4-ti Kosovar hala se din.

62% Kosovar

Kanë përjetu dhunë në familje
gjatë jetës së tyre.

256,000 Gra

124,000 Burra

Kanë përjetu dhunë në
familje në vitin 2014.

55+ Gra

Kanë gjetë vdekjen si pasojë e
dhunës me baza gjinore prej vitit 2015.

Çka osht' dhuna n'familje sipas ligjit?

Nëse niheni të humbur mrena ktij labirinti, ka njerëz që munden me të ndihmu e me u bo udhërrëfyesit tuaj.

Mbrojtësit e Viktimave munden me ju këshillu dhe me ju përkrahë:

0800 11 112. Osh't' falas dhe në shërbim 24 orë. Edhe strehimoret munden me ju këshillu dhe me ju ndihmu:

Prishtinë: 038-545-476

Gjilan: 0280-325-700, 0280-325-900

Gjakovë: 0390-330-098, 044-830-151

Mitrovicë: 028-534-351

Ferizaj: 049-334-354

Prizren: 029-234-794

Pejë: 044-278-809, 039-421-398

përdorimi i forcës

presioni psikik

kërcënimet për dhimbje fizike dhe vujtje psikike

shkaktimi i frikës, rrezikimi dhe cenimi i dinjitetit

sulmet fizike

ofendimet, sharjet, thirrjet me emra ofendues

përsëritja e sjelljeve që kanë për qëllim me e përrulë një person

marrdhania seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual

kufizimi i lirisë së lëvizjes

dëmtimi dhe shkatërrimi i pasunisë dhe kanosja për me i bo ato

frikësimi i një personi për gjendjen e tij/saj fizike, emocionale dhe ekonomike

hymja ose largimi me dhunë prej banesës/shtëpisë së përbashkët

rrëmbimi

Prëfimet e shfaqura në televizor

— "Isha me dhimtë... s'kisha fuqi, po burri rrallë vinte në shpi. Edhe kur vinte më thonte 'Hajt mos u shti se s'ki kurgjo ti'. Masnej dilke e s'vike gjithë natën n'shpi. Unë i fshehsha dhimtë mos me m'pa fëmia. Ata m'vijshin te shtrati, mi majshin duert e mëthojshin 'Gajret nanë sa të rritemi na, s'ke me vujt ma ti'..."

— "Isha e re. Pa mbush 16 vjet kam pas marrëdhanye seksuale pa dëshirën time... po të dhunshme... e humba kontrollin... dhe kjo vazhdoi sa herë i tekej atij... Nuk pranova ndihmën e familjes. Humba respektin për vetvetën e për familjen... për shoqërinë..."

— "Isha fëmi kur një kusheri provoi me më dhunue. Më kapi me zor. Më zhveshi, po fillova e ulërita n'kupë t'qiellit e i pshtova prej duerve. Ika me vrap."

— "Pa i mbush 9 vjet më vdiq nana. Mbeta me babën. Ni ditë, ai filloi me m'prek. Mi banta do gjana që si kuptojsha. 3 vjet m'ka përdor për kënaqësi seksuale. Kur i mbusha 16 vjet mu mbush kupa... Nuk mujta me përballue mo.

Lajmërova policinë...
Baba tash osht n'burg."

— "Ishim martue me dashni. Shkojshim si mas miri. Kur filloj burri me pi raki dhe me lujt lotari, nisi zullumi n'shpi. Herë çonte dorë në mu, herë në fëmi... S'pat mo kurrë rahati."

— "Prej shqetësimeve e kërcënimeve disa herë kam dështue n'shtatzani... Kam punu pa pushu. Baj ujë, ngarko dru, gatuej pa nal e tue më fye me fjalë të randa, ofendime, poshtnime... Shpirtin ma ka lëndu, jetën ma ka helmu."

— "Kom përjetue aq dhunë sa mu ka lëndu kurrizi. Sa herë mu kanë pre duert me thikë, kryet fërflue për muri. Muret e odës tonë çka s'kanë pa... T'kishin fol çka s'kishin kallxu... Sa e sa loti u derdh n'jastik, sa ofshama, sa pa hangër, pa pi. Qeshtu edhe u smuva."

— "Trupin e kisha veç sheja. Nuk gjeta qare me m'pushue dhimtë. Piva njo grusht hapa mi dhanë fund jetës. Kur m'panë në at' gjendje m'çuen në spital me ma pastrue lukthin. Erdha n'veti... Tash jom pak ma mirë."

— "Shumë kom vujt prej burrit. M'ka rreh, m'ka sha, m'ka ra... unë s'kam ba za. S'kam guxue. Sot këto të rejat dahan për një fjalë goje... s'mujn me durue... guxojnë me fol... me kundërshtu. S'priset familja për pak. Çikave t'mia ju ko thonë që duhet me durue e me ngue burrin. Za mos me lëshue..."

— "Shpesh Selvija m'kallxojke qysh burri e detyrojke me ba seks bash kur ish e lodhun e rraskapitun nga punët. M'kallxojke qysh ja kanë ba 'Hajt, se burrit duhesh me ja ba hyzmetin. Jo kur t'teket ty.'

Mas sa kohe e përdhunuan vjehrrin dhe kunatin. Kallxojke e shkreta qysh e kanë lidh për shtrati e i bajshin çka t'dojshin me trup t'saj. Se mbrojtja as ligji, e vendosi me kcy prej dritares.

Apet u bo pishmon, se tha 'Hajt bre se nashta ndrojnë.'
Po jo, qashtu e kish pas t'shkrume me hjek. Apet i njejtj avaz. Nji ditë veç kur e kom ni krismën.
E dita. Shkoj pusja."

— "Kam pasë shumë probleme shëndetësore, po, edhe n'tan qat siklet vjehrra m'bojke presion me bo fmi. Ajo ma mshelke derën e dhomës edhe i merrke çelsat me veti.

Shpesh urinojsha me ni enë n'dhomë, si mu konë shtazë... E nisha n'dhomën tjetër tu i thonë burrit 'Lsho këtë gru. A pe sheh qe s'po t'bon fmi?'

M'qoj burri ni ditë me nejt te familja jeme. Kisha nevojë me u shfry, edhe i tregojsha motrës për krejt malltretimet që po mi bon vjehrra, kur mu ka kthyo ajo 'Mos me pas bo nusja e djalit tem fmi menihere e kisha lshu!."

— "Si fëmi kam përjetu shumë tmerre. Baba e rrihte nanën deri sa i binte t'ligtë. Mas nji kohe ata u ndan. Masi nana ishte e varfun, gjyqi na caktoj me jetue me babën. Po e kemi hjek t'zitë e ullinit prej babës tua na rreh herë me, herë motrat, herë vëllanë...

Si mu duru me jetue kështu? Po pritshim me u rritë e me u largue..."

— "Familja m'ka martue me nji burr që ka gru po që ska fëmi. Masi i kam lind fëmijt mue s'më kanë lejuje me i rritë si nanë e tyne se jam me aftësi t'kufizume. Tash fëmijt janë rritë, po s'më njohin si nana e tyne..."

Shumë kom vujt prej burrit. M'ka rreh, m'ka sha, m'ka ra... unë s'kam ba za. S'kam guxue. Sot këto të rejat dahan për nji fjalë goje... s'mujn me durue...guxojnë me fol... me kundërshtu. S'prishet familja për pak. Çikave t'mia ju kom thonë që duhet me durue e me ngue burrin. Za mos me lëshue...

Jam 78 vjeç. S'kam familje teme e mu desht me shkue te vëllai. Po fëmit e tij që jonë ka 18-20 vjeç më malltretojnë, më rrehin, ma marrin pensionin, kursimet e mia.S'me nimon kurkush, as kojshi as karrshi... S'kam kah me ja majt se s'ka naj ven për pleq.

Shumë kom vujt prej burrit. M'ka rreh, m'ka sha, m'ka ra... unë s'kam ba za. S'kam guxue. Sot këto të rejat dahan për nji fjalë goje... s'mujn me durue...guxojnë me fol... me kundërshtu. S'prishet familja për pak. Çikave t'mia ju kom thonë që duhet me durue e me ngue burrin. Za mos me lëshue...

Muret Mbajtëse

A e din që kur ti thejm qato mure mujn me na nimu edhe institucionet? Të nimojnë ty që po përjeton dhunë... Të nimojnë edhe ty që po don me nimu dikon që po përjeton dhunë.

E këto tash jon' "Muret Mbajtëse", jon' institucionet që na ofrojnë ni temel t'fortë ku mujm me u mbështet, ku mujm me u shliru, ku mujm me kërku ndihmë, ku mujm me kërku drejtësi, ku mujm me siguru pamvarsi ekonomike.

E nëse edhe këto mure ju dështojnë, n'fund çelni derën te Institucioni i Avokatit t'Popullit që osht' gati për me ju ofru mbështetje nëse krejt ata tjerët përpara s'ju kanë kuptu e si kanë kry qysh duhet punët e veta.

Policia e Kosovës

A e din që ndihma ose kontakti yt i parë munet me kon Policia?

Qysh munesh me kontaktu Policinë?

Thirre **192**. Osh't' falas!

Çka munet me bo Policia për ty?

Policia e Kosovës ka oficerë një grue dhe një burrë t'specializim n'punën me rastet e dhunës në familje.

- Ata duhet me të ngu.
 - Ata duhet me të shoqëru edhe me tu përgjigj n'krejt pytjet.
 - Ata duhet me arrestu menjherë dhunusin.
 - Ata duhet me njoftu Prokurorin e Shtetit për rastin.
 - Ata duhet me të tregu për shërbimet tjera.
 - Për shembull ata ta Ishojnë Urdhrin për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente.
-

Nuk je nda e/i kënaqun me punën e policisë?

Nëse je e/i pakënaqun me punën e policisë apo me zyrtarin dhe mbikëqyrësin e tij që po mirren me rastin tand, munesh me shku edhe me raportu te Inspektorati Policor.

Inspektorati Policor

Çka duhet me bo ky institucion?

- Duhet me i hetu keqpërdorimet e detyrës së kryme nga një punëtor i Policisë së Kosovës, pa marr parasysh gradën apo pozitë që e kanë.
- Duhet me ofru informata për viktimat, me i udhëzu ato gjatë procesit dhe poashtu me i njoftu institucionet tjera që duhet.

Qysh munesh me kontaktu Inspektoratin Policor?

Thirrni 08000 3333. Osh' falas edhe punon 24 orë.

Nëse je e/i pakënaqun me shërbimin e Inspektoratit Policor, munesh me shku te Avokati i Popullit.

Prokurori i Shtetit

Çka duhet me bo Prokurori i Shtetit?

- Duhet me i shqyrto provat e një rasti për me përcaktu nëse ato janë të mjaftueshme për me arsyetu dhe mbështetë ndjekjen penale.
 - Duhet me bashkëvepru me viktimën e dhunës nëse ka nevojë.
 - Pasi që i mbledhë provat, Prokurori duhet me ngrit padi ose me i hedhë poshtë akuzat.
 - Prokurori ka për obligim me e informu viktimën për statusin e rastit të saj/tij.
-

Qysh mundeni me i raportu shkeljet e Prokurorëve?

- Ankesën mundet me e paraqit çdo person apo institucion.
 - Zyra e Prokurorit Disiplinor i nisë hetimet ndaj prokurorëve, aty ku ka fakte që ligji u shkel.
 - Kjo zyre i rekomandon Komisionit Disiplinor të Këshillit me e nisë procedurën disiplinore kundër një prokurori mbi bazën e hetimeve që janë kry.
-

Nëse nuk je e/i kënaqun me punën e prokurorit, mundesh me u drejtu te Avokati i Popullit.

Gjykatat

Për çka janë përgjegjëse gjykatat?

Gjykatat duhet me u jap përparësi rasteve të dhunës, duke i trajtu në mënyrë të drejtë dhe me respekt gjatë procedurës penale.

- Shqipton masa mbrojtëse që me parandalu dhunën në familje, që me mbrojtë personin që ka përjetu dhunë, duke i menjau rrethanat që mundet me ndiku në kryerjen e veprave tjera.

- Departamentet civile në gjykatat themelore janë përgjegjëse me nxjerrë urdhëra të menjëhershëm të mbrojtjes (brenda 24 orëve) dhe urdhëra të mbrojtjes. Ato vendosin edhe për masat mbrojtëse që nxjerrin.

- Prokuroria ka për detyrë me ndjekë shkeljen e masave mbrojtëse që paraqesin vepër penale.

A e ki ditë që Urdhëri Mbrojtës munet me të mbrojtë në mënyra të ndryshme?

Gjykata munet me shqiptu disa masa mbrojtëse të cilat e kanë qëllimin me parandalu dhunën.

Prej gjykatësit munesh me i kërku këto masa:

- Dhunusi mos me tu afru dhe mos me t'shqetsu

- Nëse dhunusi është i varun nga alkooli apo droga, kërkoje trajtimin nga varësia prej tyre

- Trajtim psikosocial për dhunusin

- Që dhunuesi me u largu nga banesa apo shpia

- E nëse ki nevojë me i marr senet e tua atëhere ki të drejtë edhe me të shoqu zyrtari policor

- Me marr sendin me të cilin osh t' kry vepra

- Lidhur me pasuninë: aty përfshihet me tu leju me qëndru në hapësinën e banimit të përbashkët, pagesën e qirasë të banimit të përkohshëm ose alimentacionit nga ana e dhunusit si për ty ashtu edhe për fëmijun.

Gjykata komunale e vendos se cilat masa kanë me u shqiptu me nji urdhër.

Qysh me mrii deri te Gjykata e duhur?

Në komunën ku ti banon dhe parashtron kërkesën, Gjykata Themelore shqipton masat mbrojtëse.

Kush munet me paraqitë kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente?

- Viktima

- Mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e viktimës

- Personi me të cilën viktima ka lidhje familjare

- Personi i cili osh t' n'dijeni për nji apo ma shumë vepra të dhunës në familje ndaj viktimës

- OJQ-të që janë familjarizu me problemin e viktimës edhe që janë njoftu mirë për trajtimin e tyre

Qysh me i raportu veprimet e paligjshme të gjyqtarëve?

- Ankesat për veprimet e gjyqtarëve munesh me i paraqitë te Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

- Kjo zyre paraqet provat dhe landën te Komisioni Disiplinor i KGJK në mbështetje të veprimeve disiplinore për sjelljen e pahishme

- Personi i interesuar paraqet ankesë tek KGJK për sjelljen e gjyqtarëve

- Edhe KGJK me vetiniciativë mundet me hap rastin

- Kundër vendimit të gjykatës themelore, pala mundet me paraqitë ankesë në Gjykatën e Apelit

Nëse nuk je e/i kënaqun me punën e gjyqtarit, mundesh me u drejtu te Avokati i Popullit.

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas

Çka të ndihmon ky institucion?

- Ndhimja juridike primare u ofrohet të gjithë personave që përfitojnë të drejtën nga ndihma sociale, ose grupeve të rrezikuara që nuk kanë mjete të mjaftueshme për mbrojtje efikase gjatë procedurës gjyqësore.
 - Ki të drejtë me kërkim ndihmë juridike falas, nëse je viktimë e dhunës në familje.
 - Ata të ofrojnë ndihmë juridike falas në përpilimin e ankesës, padisë apo dokumenteve tjera ligjore.
 - Nëse ti je viktimë, ata të mundësojnë qasje në drejtësi, duke të dhënë informata dhe këshilla ligjore, si dhe duke të përfaqësuar para gjykatave ose organeve administrative.
-

Qysh me kërkim ndihmë juridike prej këtij institucioni?

- Agjencionet për Ndhimë Juridike Falas (ZNJF) mundesh me i gjetë në Prishtinë, Pejë, Prizren, dhe Mitrovicë të Veriut.
 - E paraqet kërkesën në zyrën që e ki ma afër për ndihmë juridike falas.
 - Kur e paraqet kërkesën e ki për obligim me ofru dokumentacionin e kërkuar për të dëshmu bazën e saj.
- Ku munesh me u anku në lidhje me vendimin mbi ndihmën juridike?
- Ti ke të drejtë ankese kundrejt vendimit për refuzim të ofrimit të ndihmës juridike falas.
 - Ankesa i paraqitet Komisionit për Ankesa në afat prej 8 ditëve.
 - Komisioni merr vendim përfundimtar në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.
-

Çka nëse nuk je e/i kënaqun me shërbimet që tu kanë ofru?

Munesh me dërgu ankesë të Komisioni për ankesa të Këshillit, i cili vendosë për ankesën brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të saj.

Nëse nuk je e/i kënaqun me punën e ZNJF-së, mundesh me u drejtu te Avokati i Popullit.

Institucionet Shëndetësore dhe Arsimore

Çka shërbejnë institucionet shëndetësore?

- Pasi kanë përjetu dhunë, viktimat ma së shpeshti drejtohen njihere te qendrat shëndetësore.
 - Ato u ofrojnë viktimave trajtim shëndetësor dhe psikologjik dhe i referojnë ato tek institucionet përkatëse.
 - Mjekët e institucioneve shëndetësore duhet me e siguru konfidencialitetin e të gjitha informatave.
 - Ata duhet me u siguru që i ofrojnë viktimës të dhunës në familje kujdes shëndetësor edhe nëse nuk dojnë me raportu rastin në polici.
 - Punëtorët në qendrat shëndetësore që janë dëshmitarë të dhunës munen me nimu me raportu rastin në polici.
-

Çka nëse nuk je e/i kënaqun me shërbimet që tu kanë ofru?

- Nëse i ki kërku najno prej shërbimeve ma nalt edhe nuk je e/i kënaqun me mënyrën qysh je trajtu nga ky institucion, drejtohu te Komisioni Disiplinor edhe mandej te Drejtori i Shëndetësisë i komunës ku je.
 - Nëse edhe aty nuk gjen zgjidhje munesh me lajmëru rastin në polici. Ata duhet me fillu hetimet dhe e hapin rastin në gjykatë.
 - E nëse këto institucione nuk e hetojnë rastin sipas ankesës që e ki bo, atëherë nisu te Avokati i Popullit.
-

E çka shërbejnë institucionet arsimore?

- Disa shkolla kanë psikologë për me nimu dhe përkrah fëmijët që kanë përjetu dhunë apo kanë qenë dëshmitarë të dhunës.
- Janë burime të randsishme për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimas të dhunës në familje. Hej mësues, kur e shihni që ka dhunë, raportojeni!
- Raporto dhunën te drejtori i shkollës, pastaj te Drejtorja Komunale për Arsim.
- Nëse ata nuk bojn kurgjo shko te policia dhe Qendra për Punë Sociale, të cilët munen me ndihmu me procedurat e tjera ligjore.

Avokati i Popullit

Çka bon Avokati i Popullit?

- Adreson akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet shtetërore (p.sh. Gjykatat, Policia, Prokuroria).
 - Trajton rastet e dhunës tek të cilat janë shfaqë parregullsi dhe shkelje të të drejtave të viktimës.
-

- Pranon çdo ankesë nga personat të cilët kanë pësuar shkelje të të drejtave nga ndonji institucion shtetëror.
 - Informon institucionet kompetente për fillimin e hetimeve, nëse e sheh që osht' shkel ligji.
-

Qysh munesh me u drejtu te Avokati i Popullit?

- Thirre 0800 15555. Osht' falas!

Qendrat e Aftësimit Profesional dhe Zyrat e Punësimit

Çfarë roli kanë këto institucione?

- Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP) dhe Zyrat e Punësimit duhet me të nimu në aftësim dhe riintegrim në shoqni ty që i ke mbijetu dhunës në familje.
- Këto institucione munden ma së miri me i identifiku edhe nimu viktimat e dhunës.
- Kur hasin në këto raste ato i dërgojnë në institucione ose organizata ku mund tu jepet përkrahje.
- QAP bëjnë këshillimin profesional për punësim dhe udhëzim në karrierë, ndërmjetësimin në procesin e punësimit, ofrimin e informatave për punëkërkesit etj.
- Këto shërbime munden me ju ofru edhe viktimave që nuk janë strehu në strehimore.

Keni ankesë për punën e QAP?

Ankesën munesh me çu te drejtori i QAP, Inspektorati i punës, apo në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Divizioni për shqyrtimin dhe parashtrimin e ankesave.

Nëse edhe me këto insitucione nuk je e/i kënaqun, atëherë nisu te Avokati i Popullit.

Qendra Për Punë Sociale

Çdo komunë ka një Qendër për Punë Sociale.

Çka të shërben kjo Qendër?

- Mbron qytetarët në nevojë për shërbime sociale dhe familjare.
- Mbron dhe ofron shërbime ndaj personave që kanë përjetu dhunë në familje.
- Ofron shërbime sociale si mbrojtja, rehabilitimi dhe integrimi i viktimave në shoqni.
- I cakton secilës viktimë një menaxher të rastit.
- Menaxheri i rastit e vlerëson gjendjen ekonomike dhe sociale të viktimave të dhunës.
- Në rastet në gjykatë, punëtori social dëshmon për nevojat e fëmijut duke marrë parasysh interesin e tyre, përfshi edhe përcaktimin e një kujdestari nëse është nevoja.
- Siguron konfidencialitetin e të dhënave.

A e din që munesh me u anku nëse:

- Nji punëtor social shpërndan informacionet lidhur me rastin tand;
- Menon që je diskriminu padrejtë;
- Menon që padrejtë tu kanë mohu shërbimet sociale;
- Menon që punëtori social ka marr vendim të padrejtë për shërbimet sociale.

Procedura e ankesës:

- Drejtori i QPS-së me rishqyrtu rastin;
- Nëse s'je e/i kënaqun me përgjigjen e Drejtorit, munesh me vazhdu ankesën te Departamenti i Mirëqenies Sociale;
- Komisioni për ankesa duhet me shqyrtu ankesën dhe dokumentacionin dhe sipas nevojës me intervistu dëshmitarët;
- E nëse je e/i pakënaqun me vendimin e Komisionit për ankesa, munesh me u drejtu ne polici apo ne gjykate.

Nëse nuk je e/i kënaqun me punën e ketyre institucioneve, mundesh me u drejtu te Avokati i Popullit.

Strehimoret

Çka shërbejnë strehimoret?

- Ofrojnë shërbime strehimi për gratë dhe fëmijët që kanë përjetu dhunë në familje.
 - U ofrojnë viktimave një vend të përkohshëm e të sigurtë për të jetu në rast se rrezikohen nga dhuna në familje.
 - Kosova ka tetë strehimore në: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Novobërdë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe jug të Mitrovicës
-

Çka ofrojnë Strehimoret?

- Mund të paraqesin kërkesa për urdhra të mbrojtjes dhe urdhra mbrojtje emergjente.
 - Ndhimojnë viktimat gjatë procesit të rimarrjes së vetës nga dhuna në familje duke përfshirë kujdesin psikologjik, fizik, rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqni.
 - Shumica e strehimoreve ofrojnë edhe ndihmë juridike.
 - Disa kanë lidhur bashkëpunime me bizneset lokale që ju lehtëson punësimin e grave.
 - Të gjitha shërbimet në strehimore ofrohen falas.
-

Qysh mundesh me u drejtu në strehimore?

Nëse je viktimë e dhunës në familje, ti munesh me kërku ndihmë drejtpërdrejtë nga një strehimore.

Prishtinë: 038-545-476

Gjilan: 0280-325-700, 0280-325-900

Gjakovë: 0390-330-098, 044-830-151

Mitrovicë: 028-534-351

Ferizaj: 049-334-354

Prizren: 029-234-794

Pejë: 044-278-809, 039-421-398

Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave

Çka duhet me bo kjo Zyrë?

-Takohen me viktimat menjëherë pas reagimit të policisë.

- Ndërton një raport me viktimën që zgjatë gjatë tërë procesit.

- Përfaqëson interesat e viktimave duke kërku në emër të tyre mbrojtje të të drejtave.

- Sigurohen që viktima i kupton shërbimet që mund t'i ofrohen nga shteti dhe qysh me i pranuar ato.

-Identifikon burimet për ti plotësuar nevojat e viktimave të krimit dhe për të nxitur rehabilitimin e tyre.

- Identifikon magësitë në shërbime dhe bashkëpunojnë në koordinim me ofruesit e tjerë të shërbimeve për t'i plotësuar sa më mirë nevojat e viktimave.

Ku është Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave?

Në Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

Zyrat regjionale janë të vendosura në 7 rajone brenda Republikës së Kosovës: në Prishtinë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë.

Qysh me i kontaktuar Mbrojtësit e Viktimave?

Thirrje 0800 11 112. Oshet' falas dhe në shërbim 24 orë.

Nëse nuk je e/i kënaqur me punën e mbrojtësve të viktimave, ki drejtë mu anku te menaxheri i zyrës, mandej te prokurori i shtetit i cili hap rastin në gjykatë dhe n'fund mundesh mu drejtu te Avokati i Popullit.



Financuar nga
Bashkimi Europian



FINANCIUAR NGA
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

